Në IKSHPK po mbahet vazhdimi i Konferencës së Dytë Rajonale për Promovim dhe Edukim Shëndetësor

Prishtinë 27 tetor, 2017

Në vazhdimësi të Konferencës së Dytë Rajonale për Promovim dhe Edukim Shëndetësor, sot në Institutin Kombëtar në Prishtinë është mbajtur sesioni plenar me temën "Teknikat e mësimit të të rriturve për shëndetin seksual dhe riprodhues dhe të drejtat riprodhuese".

Në kuadër të këtij sesioni, ekspertja nga Rumania, Dr. Lavinia Mihaela Nanu, bëri disa prezantime rreth kësaj teme, duke paraqitur edhe disa klipe të shkurtra para të pranishmëve.

Në konferencë, u prezantuan edhe aktivitetet e Komisionit të Edukimit Shëndetësor (KESH) në rajonin e Prishtinës, ku u tha se ky komision përveç tjerash bën edhe shënimin e ditëve botërore, me aktivitete të ndryshme nëpër shkolla fillore e të mesme, si dhe me fushata vetëdijësuese.

Temë tjetër e kësaj konference ishte : "Promovimi dhe Edukimi Shëndetësor në Institucionet Shëndetësore dhe bashkëpunimi ndërsektorial", ku u prezantua Projekti për Edukim dhe Promovim Shëndetësor në SHFMU të Komunës së Prishtinës.

Në sesionin e tretë u bënë prezantime rreth njohurive, praktikave e qëndrimeve mbi sëmundjet ngjitëse, shëndetin e fëmijëve dhe të drejtat e qytetarëve në shëndetësi.

Ndërsa sesioni i katërt, do të vazhdojë me prezantimin e temës "Sëmundjet kronike jo ngjitëse, faktorët e rrezikut, grupet

vulnerabile, me anë të së cilës do të paraqiten raporte të tumoreve malinje të lëkurës, të raportuara në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, për vitet 2012-2014.



Në Prishtinë po mbahet Konferenca e Dytë Rajonale për Promovim dhe Edukim

Shëndetësor

Komunikatë për media

Në Prishtinë po mbahet Konferenca e Dytë Rajonale për Promovim dhe Edukim Shëndetësor

Prishtinë, 26 tetor 2017

Organizuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHP) në bashkëpunim me Asociacionin Kosovar për Promovim dhe Edukim Shëndetësor dhe mbështetur nga Projekti Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor (AQH), sot në Prishtinë i ka filluar punimet Konferenca e Dytë Rajonale për Edukim dhe Promovim Shëndetësor me temën: "Të mësojmë nga përvojat".

Në këtë konferencë me pjesëmarrës edhe nga vendet e rajonit dhe me gjerë, profesionistë të fushave të shëndetësisë publike prej 26-28 tetor, do të bëjnë prezantime të ndryshme lidhur me edukimin dhe promovimin shëndetësor në kontekst të zhvillimeve të shëndetit publik dhe në funksion të ruajtjes dhe përparimit të shëndetit publik.

Në hapje të kësaj konference, zëvendësministri i Shëndetësisë i Republikës së Kosovës, dr. Ali Berisha, tha se konferenca e Dytë Rajonale për Edukim dhe Promovim Shëndetësor është një kontribut i drejtpërdrejt shkencor në sigurimin e ekspertizës, profesionalizmit dhe përgjegjësisë për ndërmarrjen e masave efikase për parandalimin e çfarëdo rreziku për shëndetin e popullatës, në këtë kohë kur problemet e shëndetit publik, janë një kërcënim i përhershëm si në nivelin rajonal ashtu edhe në atë global.

"Qëllimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është sigurimi i shëndetit të plotë për të gjithë si një e drejtë themelore,

ndërsa IKSHP ka një mision të rëndësisë së veçantë në përmbushjen e misionin për përparimin e kualitetit të jetës, përmes parandalimit të sëmundjeve dhe promovimit të shëndetit. Në zbatim të Strategjisë Sektoriale Shëndetësore dhe objektivave të saj për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit; sigurimin e një financimi të qëndrueshëm dhe ri-organizimin e sektorit të shëndetësisë, objektiva këto që reflektojnë edhe në Programin qeveritar për shëndetësi, Ministria e Shëndetësisë do të mbështes Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe institutet rajonale, që të rrisin kapacitetet e tyre për zbatimin me sukses të punës së tyre profesionale dhe shkencore, me qëllim që të ketë një vazhdimësi të sukseseve dhe të kemi një popullatë të shëndoshë", tha zëvendësministri Berisha.

Prof.dr. Naser Ramadani, Drejtor ekzekutiv i IKSHP-së, tha se IKSHP si institucioni më i lartë shëndetësor, profesional dhe shkencor i Kosovës angazhohet me përkushtim në zbatimin e veprimtarisë në fushën e shëndetit publik duke ndërmarrë masa kundërepidemike, promovimin dhe edukimin shëndetësor, kontrollin e kualitetit të ujit, ajrit e ushqimit, si dhe zbatimin e Programit të Zgjeruar të Imunizimit në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

Ai tha se një konferencë si kjo, vjen në vazhdën e rezultateve të shënuara në shëndetësinë publike nga të cilat duhet duhet përmendur se me zbatimin e Programit të Zgjeruar të Imunizimit janë shënuar suksese evidente në luftimin e sëmundjeve infektive në vendin tonë. "Fëmijët në Kosovë sot nuk sëmuren më nga sëmundjet ngjitëse nga të cilat kanë vdekur në të kaluarën. Sot, ne nuk kemi të regjistruar epidemi të difterisë, të tetanosit neonatal, paralizës së fëmijëve, rubellës, shytave. Sot në Kosovë nuk shihni më fëmijë të lidhur për karrocën e invalidit si pasojë e paralizës së shkaktuar nga virusi i egër i Polios", thksoi profesor Ramdani.

Ai tha se këto suksese, sidomos në luftën kundër 10

sëmundjeve vaksinë-preventabile nuk do të arriheshin pa mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe sigurisë së vaksinave të certifikuara nga OBSH dhe të përzgjedhura sipas këtyre kritereve nga UNICEF.

Profesor Ramadani tha se me gjithë sfidat që mbesin, vitet e fundit janë realizuar, poashtu, me sukses një varg projektesh shkencore si: Gripi i shpendëve, Hulumtimi për Ethet Hemorragjike Krime Kongo, Tulareminë e Brucellozën, Hulumtimi i kualitetit të shërbimeve të vaksinimit, Përforcimi i kapaciteteve të Qendres së ujit, Luftimi i rezistencës së antibiotikëve, ndërkohë që është duke u bërë implementimi i Regjistrave të Kancerit, Diabetit, Sëmundjeve Kardiovaskulare.

“Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike do të vazhdojë të jetë i përkushtuar në angazhimin e vet bashkë me të gjitha institucionet e vendit për të përmbushur vizionin për një popullatë të shëndoshë, në mjedisin e shëndoshë, në një shtet të shëndoshë”, tha profesor Ramadani.

Punimet e konferencës i ka përshëndetur edhe ushtruesi i detyrës së drejtorit të SHSKUK-së dr. Basri Sejdiu, Drejtori i Institutit të Shëndetit Publik të Maqedonisë, Shaban Mehmeti, Zëvendësdrejtori i Institutit të Shëndetit Publik të Shqipërisë, Genc Burazeri si dhe përfaqësuesit e agjensioneve dhe institucioneve mbështetëse të kësaj konference si AQH, OBSH, UNICEF, UNFPA, etj.

Konferenca i vazhdon punimet edhe të premtën dhe të shtunën.



Njoftim për vaksinim me MMR

Duke analizuar situatën epidemiologjike me fruth në Kosovë, - Komiteti Nacional për Sëmundje Ngjitëse dhe PZI ka obliguar - ditë më parë ekipet e vaksinimit që:

– Të vaksinojnë të gjithë fëmijët nga muaji i nëntë i jetës me 1 dozë prej 0.5 ml
– Nëse fëmija është 5 vjec duhet të rivaksinohet me MMR dhe nuk ka nevojë të pritet mosha 6-7 vjec.
– Nëse fëmija është mbi 7 vjec dhe nuk është i vaksinuar - fare, atëherë vaksinohet me 1 dozë MMR menjëherë dhe pas n- jë muaji me booster dozën me MMR.
Lajmi i mirë në këtë mes është se numri i rasteve të fruthit është duke shënuar rënie. Nga 200 raste q-

ë janë paraqitur nga muaji qershor, 150 tashmë janë trajtuar, kurse 49 janë në trajtim e sipër.

Megjithatë, ne ju bëjmë thirrje edhe njëherë të gjithë qytetarëve të Kosovës që të marrin të gjitha masat e sipërpërmendura në mënyrë që të shuhet epidemia me fruth në vend.

Informacion për publikun

Informacion për publikun

Data: 19 Tetor 2017



Në fillim të shtatorit 2017, në Kosovë u raportuan 44 raste të fruthit. Deri më 19 tetor, 163 raste të fruthit janë raportuar në mesin e fëmijëve të cilët nuk janë vaksinuar.

Fruthi është një sëmundje shumë ngjitëse dhe serioze e shkaktuar nga një virus. Virusi përhapet nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë dhe përmes ajrit dhe mund të përhapet shpejt sidomos aty ku përfshirja me vaksinim rutinor ka qenë vazhdimisht nën 95%, duke lejuar akumulimin gradual të individëve lehtë të prekshëm nga virusi. Sëmundja mund të jetë vdekjeprurëse, sidomos tek fëmijët dhe të rriturit me sëmundje te tjera ekzistuese si dhe sistem imunitar te kompromet uar.

Kosova ka një nivel të lartë imunizimi që është mbajtur përmes përfshirjes me vaksinim rutinor prej ≥ 95% me dy doza të vaksinës kundër fruthit. Me përjashtim të popullatave

vështirë për t’u arritur, sipas MICS 2015, vetëm 3 në 10 fëmijë Romë, Ashkali dhe Egjiptas janë plotësisht të imunizuar. Kjo situatë ka krijuar gradualisht në disa vende disa fëmijë të cilët nuk mbulohen ose nuk arrihen nga vaksinat rutinë.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike duke u bazuar në dëshmi ndërkombëtare dhe udhërrëfyesit e OBSH-së ka zhvilluar një plan operativ dhe është duke ndërmarrë masat dhe veprimet e nevojshme në bashkëpunim me mjekët dhe infermierët komunalë për të shpëtuar jetë, për të kontrolluar gjendjen e vazhdueshme të fruthit, dhe për të parandaluar rastet e reja të fruthit.

IKSHP-ja që nga rasti i parë i fruthit, ka intensifikuar aktivitetet e vaksinimit me vaksinën MMR kryesisht tek popullata e përfshirë me fruth, por edhe të gjithë popullsinë në të gjitha vendet që raportojnë fruthin.

Nën udhëheqjen e Ministrit të Shëndetësisë, u mbajt një takim nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, UNICEF dhe OBSH për të rishikuar statusin e reagimit aktual të programit në situatën në vazhdim. Për këtë qëllim, IKSHP-ja po merr masat dhe veprimet e nevojshme në bashkëpunim me mjekët dhe infermierët në kujdesin parësor në komuna, për të shpëtuar jetën, për të mbajtur gjendjen e vazhdueshme të fruthit dhe për të parandaluar rastet e reja të fruthit.

IKSHPK do të vazhdojë të bashkëpunojë me UNICEF-in dhe OBSH-në sipas rekomandimeve të OBSH-së për të përmirësuar planin e komunikimit dhe aktivitetet e mobilizimit social për të

adresuar keqkuptimet dhe për të ngritur vetëdijësimin te familjet, komunitetet dhe publiku për të përforcuar imunizimin rutinor të fëmijëve te familjet e cenueshme. Kjo është arsyeja pse ekipet e vaksinimit janë të përkushtuara për të vaksinuar fëmijët shtëpi për shtëpi dhe për të zgjeruar vaksinimin rutinor të fëmijëve në institucionet shëndetësore, veçanërisht për familjet Rome, Ashkali dhe Egjiptiane. Për më tepër, IKSHPK gjithashtu është e kënaqur me përgjigjen pozitive të prindërve dhe të familjeve, dhe nëse ky momentum mbahet, shkalla e imunizimit do të përmirësohet në mënyrë progresive.

Information to the Public

Information to the Public

Date: 19 October 2017



At the Beginning of September 2017, 44 cases of measles were reported in Kosovo. As of October 19th, 163 cases of measles were reported among children who are not vaccinated.

Measles is a highly contagious, serious disease caused by a virus. The virus is passed on through direct contact and through the air, and can spread quickly especially wherever routine immunization coverage has been persistently below 95%, allowing for the gradual accumulation of susceptible individuals. The disease can be lethal, especially in children and adults with existing health conditions (other diseases, compromised immune system). In under immunized populations, the virus will continue to circulate among susceptible individuals. The only way to prevent measles is through a prompt and comprehensive response to immunize all children. Measles can spread to any country, including to those that have eliminated endemic transmission of the virus.

Kosovo has a high immunization level of ≥95% with two doses of

measles containing vaccines. Except for hard to reach populations, according to MICS 2015, only 3 in 10 Roma, Ashkali and Egyptian children are fully immunized. This situation has gradually created some pockets of children who are not covered or reached by routine vaccinations.

National Institute of Public Health has already based on international evidence and WHO guidelines developed an operational plan is taking necessary measures and actions in collaboration with municipal-based doctors and nurses to save lives, to contain the on-going situation of measles and to prevent new cases of measles from occurring.

NIPH since the first case of measles, has intensified vaccination activities with MMR vaccine primarily to affect but also to all population in all territories reporting measles;

Under the leadership of the Minister of Health, a meeting was held by the National Institute of Public Health, UNICEF and WHO to review the status of the current programme response to the on-going situation. To this end, the NIPH is taking necessary measures and actions in collaboration with municipal-based doctors and nurses to save lives, to contain the on-going situation of measles and to prevent new cases of measles from occurring.

NIPH will continue working with UNICEF and WHO according to WHO recommendations to further improve communications plan and social mobilizations activities to address some misconceptions and increase awareness among families, communities and public to strengthen routine immunization of children from vulnerable families. That is the reason why immunization teams are committed to vaccinate children through house to house mass vaccination and to expand routine vaccination of children in health facilities, especially for Roma, Ashkali and Egyptian Families. Furthermore, the NIPH is also excited to witness the positive response from parents and families, and if this

momentum is kept, the immunization rate will progressively improve.

Si të mbrohemi nga gripi

Gripi sezonal

Gripi sezonal është një infeksion akut viral. Transmetohet direkt nga një person i sëmurë tek tjetri përmes stërpiklave gjatë kollitjes ose teshtitjes dhe ne menyre indirekt me prekjen e objekteve të kontaminuara me virusin e gripit sezonal.

Për sa kohë një person i sëmurë e përhap gripin tek të tjerët?

Personi i infektuar me virusin e gripit mund të jetë infektues për të tjerët, 1 ditë para se të sëmuret dhe 5 ditë pas shenjave të gripit. Tek fëmijët, apo personat me imunitet të ulur, periudha e infektimit mund të jetë pak më e gjatë.

Kush rrezikohet nga gripi sezonal?

Çdo njeri mund të preket nga virusi i gripit sezonal dhe ta përhapë atë tek të tjerët. Por disa njerëz janë në rrezik më të madh për t’u infektuar me virusin e gripit sezonal si:

• Fëmijët e vegjël nën 5 vjeç, sidomos deri në 2 vjeç

• Njerëzit 65 vjeç e sipër

• Gratë shtatëzëna.

• Njerëzit me sëmundje kronike.

Shënjat e zakonshme të gripit sezonal janë:

• Temperaturë e lartë

• Kollë

• Dhimbje fyti

• Lodhje

• Dhimbje koke

• Diarre dhe vjellje

• Dhimbje barku

• Rrjedhje të hundëve

• Dhimbje muskujsh

Shënjat paralajmëruese për emergjencë.

Duhet të dini se sëmundja zakonisht zgjat rreth një javë POR drejtohuni menjëherë tek mjeku nëse:

Fëmijët shfaqin:

• Frymëmarrje te shpejtë, ose probleme me frymëmarrjen

• Ndryshim të ngjyrës së lëkurës

• Nuk konsumojnë mjaftueshëme lëngje

• Kanë ethe me një skuqje të lëkurës

• Fortësim te qafës

Të rriturit shfaqin:

• Vështirësi në frymëmarrje apo gulçim

• Dhimbje apo presion në gjoks apo bark

• Marramendje të papritur

• Konfuzion mendor

• Të vjella të vazhdueshme

Si te mbrohemi nga virusi i gripit sezonal?

Ju rekomandojmë tre hapa për të luftuar gripin: vaksinimin, masat e përditshme parandaluese, dhe trajtimi me barna antivirale nëse mjeku i rekomandon.

I. Vaksinimi.

Vaksinimi mbron vetë personin dhe ndihmon në parandalimin e përhapjen se gripit.

• Vaksinimi kundër gripit bëhet në muajt tetor – dhjetor.

• Efekti i vaksinës fillon 1 deri 2 javë pas marrjes

• vaksina aplikohet në pjesën e sipërme të krahut.

Vaksina kundër virusit të gripit i rekomandohet sidomos :

• Fëmijëve mbi 6 muaj

• Personave mbi 50 vjeç

• Personave me rrezik më të lartë

• Personelit shëndetësor

• Grave shtatëzëna

• Personat kujdestarë si edukatoret e çerdheve, kopshteve, kujdestarët e te moshuarëve.

Vaksina kundër virusit të gripit nuk i rekomandohet :

• Personave që kanë alergji në vezë

• Gjendje akute me temperaturë

• Fëmijët nën 6 muaj

II Masat e përditshme që ndihmojnë në parandalimin e përhapjes së virusit të gripit sezonal

• Mbuloni hundën dhe gojën kur kolliteni ose teshtini me faculetë.

• Lani duart shpesh me sapun dhe ujë ose përdorni desinfektues.

• Shmangni prekjen e syve, hundës dhe gojës.

• Përpiquni të shmangni kontaktet e ngushta me njerëzit e sëmurë.

• Ushqehuni shëndetshëm

• Bëni aktivitet fizik

• Bëni gjumë të mjaftueshëm.

• Pastroni dhe dezinfektoni mjediset ku banoni

Konsultohuni me mjekun për mjekimin me barna kundër gripit
Barnat kundër gripit nuk kanë efekt parandalues, por mjekues. Ato përdoren vetëm nëse jeni të sëmurë me grip dhe **duhen të merren brenda 48 orëve nga fillimi i sëmundjes.**

Kujdes, antiviralët jepen vetëm me rekomandimin e mjekut

Këshilla

Nëse jeni të sëmurë me grip :

• Qëndroni në shtëpi.

• Qëndroni veç nga të tjerët

• Pushoni dhe përdorni lëngje me shumicë

• Mbuloni gojën dhe hundën me faculetë kur kolliteni apo teshtini

• Lani duart mirë me ujë e sapun mbas çdo kollitje apo teshtimi

• Informoni familjarët dhe miqtë tuaj për sëmundjen tuaj

• Evitoni kontaktet me njerëzit

Në IKSHPK është mbajtur takim me përfaqësuesen e OJQ Voice of Roma, Ashkali and Egyptians

Prishtinë, 13 tetor 2017

Drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, Prof. Dr Naser Ramadani zhvilloi sot një takim pune me zonjën Kadrije Krasniqi, koordinatore për të drejtat e njeriut në OJQ Voice of Roma, Ashkali and Egyptians. Në takim ishte prezente edhe Prof. Dr Isme Humolli, Drejtoreshë e Departamentit të Epidemiologjisë dhe Dr. Sci Drita Salihu, Shefe Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor në IKSHPK.

Në këtë takim u diskutua për situatën epidemiologjike me fruth në Komunitetin RAE, duke pasur parasysh se shumica e numrit të pacientëve të sëmurë nga fruthi janë nga ky komunitet.

Koordinatorja Krasniqi ofroi ndihmën në teren përmes aktivistëve të OJQ Voice of Roma, Ashkali and Egyptians.

U diskutua për mundësinë e shpërndarjes së lifletit me të dhënat themelore për mbrojtje nga Fruthi dhe obligimin ligjor për të gjithë fëmijët për vaksinim kundër fruthit dhe sëmundjeve tjera vaksinë preventabile.

Instituti Kombëtar e njoftoi koordinatoren me aktivitetet e zbatimit të planit të veprimit për fruthin dhe ofroi mbështetje profesionale në parandalimin e fruthit dhe sëmundjeve ngjitëse në Kosovë.



Në IKSHPK është mbajtur takim me përfaqësuesit e UNICEF-it dhe OBSH-së

Prishtinë, 12 tetor 2017

Drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, Prof. Dr Naser Ramadani zhvilloi sot një takim pune me z. James Mugaju, Zëvendësshef i Zyrës së UNICEF-it në Kosovë dhe Dr Agron Gashi, Udhëheqës i Sektorit për Shëndetësi dhe ushqyeshmëri, si dhe me Dr Ardita Tahirukaj, Shefe e zyrës së OBSH-së në Kosovë. Në takim ishte prezente edhe Prof. dr Isme Humolli, Drejtoreshë e Departamentit tþ Epidemiologjisë në IKSHPK.

Në këtë takim u diskutua për situatën epidemiologjike me fruth në Kosovë prej paraqitjes së rasteve të para e deri sot. Instituti Kombëtar është duke e përcjellur me vëmendje ecurinë e fruthit duke dhënë rekomandime për parandalimin e rasteve të reja.

Zyrat e UNICEF-it dhe OBSH-së në Kosovë ofruan mbështetje profesionale dhe financiare në rast nevoje të realizimit të projekteve që kanë të bëjnë me parandalimin e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë.

IKSHPK, UNICEF dhe OBSH bëjnë apel te të gjithë prindët të cilët për shkaqe të ndryshme nuk i kanë vaksinuar fëmijët e tyre kundër fruthit por edhe kundër sëmundjeve tjera vaksinë preventabile, të lajmërohen menjëherë në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familiare në komunat përkatëse për të mbrojtur

shëndetin e fëmijëve të tyre

Instituti Kombëtar falënderoi UNICEf-in dhe OBSh-në për përkrahjen e vazhduar dhe bashkëpunimin e shlkëlqyer në të gjitha fushat e shëndetësisë publike dhe u zotua se do të realizojë me përpikmëri planin e veprimit për parandalimin e fruthit në Republikën e Kosovës.



VAKSINONI FËMIJËT QË TI KENI TË SHËNDOSHË!

Prishtinë, 11 tetor 2017

KOMUNIKATË PËR SITUATËN EPIDMIOLOGJIKE TË FRUTHIT NË KOSOVË

Kosova radhitet në mesin e vendeve me përqindje të lartë të vaksinimit. Sipas statistikave zyrtare, rreth 95 për qind e fëmijëve, janë vaksinuar, sukses ky që ka parandaluar epidemitë për 10 sëmundje vaksinë preventabile.

Fruthi, është një nga sëmundjet, që falë vaksinimit, nuk kishte shënuar epidemi në Kosovë. Por, këtë vit, megjithatë janë shënuar 94 raste raste të fruthit të diagnostikuara në laboratoret e Institutit Kombëtar. Pjesa dërmuese e rasteve të fruthit janë regjistruar në komunitetin RAE dhe fëmijët e riatdhesuar që të gjithë të pavaksinuar.

Sipas Programit të Zgjeruar të Vaksinimit, vaksinimi kundër fruthit me vaksinën MMR është i obliguar me Ligj dhe i nënshtrohen të gjithë fëmijët e moshës 12 muajshe dhe ajo 6 vjeçare me 1 dozë prej 0.5ml. Nëse fëmija nuk është vaksinuar në periudhën kohore të caktuar, prindi është i obliguar të kompletojë statusin vaksinal të fëmijës sa më parë. Përjashtim bëjnë vetëm fëmijët që për çfarëdo arsye qoftë kanë kundërindikacion specifik për vaksinim.

Sëmundja e fruthit karakterizohet me shkallë të lartë të infektueshmërisë andaj edhe përhapja brenda territorit të caktuar është e shpejtë. Rreziku ndër-shtetëror i importimit të sëmundjes nga vendet fqinje dhe vendet e Europës është

permanent pasi që sëmundja përhapet me ajër.

Viteve të fundit sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, fruthi ka "rilindur" në Evropë, ku numri i njerëzve të infektuar që nga viti 2007, është trefishuar nga shkaku se nuk janë vaksinuar me rregull. Në shumë vende të Europës janë regjistruar të sëmurë dhe të vdekur nga Fruthi: Rumani 5920 raste me 25 vdekje, Itali 1290 raste, Gjermnai 504 raste, Belgjike 218 raste, Danimarkë 134 raste, Çeki 92 raste, Austri 75 raste, Bullgari 72 raste, Spanjë 46 raste.

Në vitin 2011, miratohet plani strategjik për vaksinim të grupeve vulnerabile të popullatës veçënërisht të komunitetit RAE. Fokusi është vaksinimi me MMR (kundër fruthit, shytave dhe rubellës) dhe OPV vaksina kundër paraliës së fëmijëve. Në vazhdimësi janë organizuar fushata të vaksinimit të fokusuara në këto grupacione të popullatës. Që nga paraqitja e rastit të parë të fruthit janë intensifikuar aktivitetet për vaksinim me MMR vaksinë dhe atë:

- Vaksinimi i rregullt i fëmijëve të bëhet në moshën 10 muajshe (mos të pritet 12 muajsh i jetës)
- Fëmijët deri në moshën 9 vjeçare të kenë / 2 doza MMR (fruth, shyta, rubellë)
- Fëmijët e shkollave të vaksinohen sa më parë

Sidoqoftë, ata fëmijë të cilët janë vaksinuar me kohë sipas kalendarit të vaksinimit nuk do të sëmuren nga Fruthi dhe nga sëmundjet tjera vaksinë preventabile.

Situata epidemiologjike me fruth është në kontrollë të plotë dhe në mbikëqyrje permanente nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike. Duke qenë se po hyjmë në stinën e ftohtë të dimrit, kur qytetarët mblidhen në dhoma të ngrohta, të paajrosura mundësia e përhapjes së fruthit rritet, por gjithnjë vetëm te fëmijët e pavaksinuar.

Të gjithë ata fëmijë të vaksinuar me rregull nuk do të sëmuren nga fruthi!

Instituti Kombëtar në mbështetje të Ministrisë së Shëndetësisë ka siguruar doza të mjaftueshme të vaksinave kundër fruthit dhe sëmundjeve tjera vaksinë preventabile. dhe po implementon masat parandaluese e kontrolluese.

Përmes aktiviteteve të veçanta, Instituti Kombëtar dhe QKMF-të bashkë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme po tenton të gjejë të gjithë fëmijët e komunitetit RAE të cilët një numër i tyre janë regjistruar me identitet të ndryshëm në Kosovë dhe identitet tjetër kur lëvizin në vendet fqinje!

Andaj, apelojmë te të gjithë prindët të cilët për shkaqe të ndryshme nuk i kanë vaksinuar fëmijët e tyre kundër fruthit por edhe kundër sëmundjeve tjera vaksinë preventabile, të lajmërohen menjëherë në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familiare në komunat përkatëse për të mbrojtur shëndetin e fëmijëve të tyre.

Lusim Televizionin Publik të Kosovës që këtë apel ta emitojë edhe në gjuhën serbe, turke dhe rome. Lusim të gjitha mediat e shkruara dhe elektronike të publikojnë këtë apel në hapësirat e tyre.

RAPORT VJETOR PËR CILËSINË E UJIT TË PIJSHËM NË KOSOVË 2016

RAPORTI për cilësinë e Ujit për pije në Kosovë, 2016

The quality of drinking water EN